

KOMPETENCAT PEDAGOGJIKE TË MËSIMDHËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA NË KOSOVË

Agim Bujari
 Instituti Pedagogjik i Kosovës
 E-mail: agim.bujari@rks-gov.net
agim.bujari@gmail.com

Abstrakt

Kompetenca pedagogjike e mësimeve është aftësia për të menaxhuar mësimin, gjegjësisht klasën dhe orën mësimore, e cila përfshin planifikimin, implementimin dhe vlerësimin e rezultateve të të nxënësve. Kompetencat pedagogjike: njohuritë, aftësitë, shprehjet, si dhe mënyrat dhe mjetet e realizimit të aktivitetit në komunikim, zhvillim dhe vetëzhvillim të personalitetit, duhet t'i zotërojnë çdo mësimeve.

Cilësia e kompetencës luan rol të rëndësishëm në krijimin dhe vendosjen e cilësisë së procesit të të nxënësve për nxënës, tregon nivelin e profesionalizmit të mësimeve sipas fushës së tyre, si dhe mund të kontribuojë në përmirësimin e performancës së të nxënësve.

Qëllimi i studimit të kësaj teme është të konstatohen cilat kompetenca pedagogjike i zotërojnë mësimeve dhe shkollave të mesme të larta.

Popullacionin e hulumtimit e përbëjnë të gjithë mësimeve dhe shkollave të mesme të larta në Kosovë, kurse grupin përfaqësues e përbëjnë 270 mësimeve. Mënyra e pjesëmarrjes së mësimeve është e rastësishme.

Studimi është i natyrës sasiore dhe për realizimin e tij si instrument është përdorur pyetësori për mësimeve, i shkallës Likert. Analiza e të dhënave është bërë përmes programit SPSS 21. Për realizimin e punimit, janë zbatuar metoda e analizës së dokumentacionit, metoda statistikore dhe metoda krahasuese. Përmes pyetjeve janë marrë opinionet e mësimeve për kompetencat pedagogjike që i zotërojnë dhe njëkohësisht është përmblur qëllimi i hulumtimit.

Bazuar në rezultatet e përgjithshme, 88.7% e mësimeve konsiderojnë se kanë kompetenca pedagogjike të nivelit të lartë, 8.3 % konsiderojnë se kompetencat e tyre janë në nivelin mesatar, ndërsa 3 % konsiderojnë se kompetencat i kanë në nivel të ulët, mesatarja e përgjithshme $M=4.4$. Rezultatet empirike vërtetuan se ka dallime në zotërimin e kompetencave pedagogjike nga ana e mësimeve. Këto rezultate treguan se mesataren më të lartë për kompetencat pedagogjike e kanë mësimeve dhe gjimnazeve, $M=141.05$, pastaj mësimeve dhe shkollave profesionale, $M=139.53$, ndërsa mesataren më të ulët e kanë mësimeve dhe shkollave të kombinuara, $M=98.93$, vlera e $X^2=7.438$, $p=0.024<0.05$.

Rezultatet empirike dëshmojnë se mësime dhënësit kanë vetëbesim të lartë për kompetencat e tyre pedagogjike. Mësime dhënësit e gjimnazeve nivelin e kompetencave pedagogjike e kanë më të lartë se mësime dhënësit e shkollave profesionale dhe shkollave të kombinuara. Rezultatet e hulumtimit tregojnë nivel më të lartë të kompetencave për përdorimin e TIK-ut nga mësime dhënësit e moshës më të re, si dhe zotërim më të lartë të kompetencave pedagogjike nga mësime dhënësit e gjinisë femërore.

Mësime dhënësit tregojnë nivel të lartë të kompetencave pedagogjike, të cilat u ndihmojnë atyre të menaxhojnë me sukses procesin mësimor, duke filluar nga planifikimi, deri në procesin e vlerësimit të nxënësve.

Fjalët çelës: kompetencë, pedagogjike, mësime dhënë, shkollë e mesme e lartë.

HYRJE

Kompetenca është kombinimi i njohurive, shprehive, qëndrimeve dhe bindjeve në përshtatje me kontekstin. Kompetencat janë aftësitë e mësimdhënësve për të kryer me sukses procesin e mësimdhënies. Sa më të pranishme/theksuara që i kanë kompetencat mësimdhënësit, aq më lehtë dhe më mirë mund të ushtrojnë profesionin e tyre. Përmes aktiviteteve të ndryshme jetësore, përvoja, shkollimi, kontaktet me njerëz të ndryshëm, etj., bëjnë që mësimdhënësit të zotërojnë disa aftësi të përgjithshme, të cilat u ndihmojnë të jenë efikas në punë. Mësimdhënësit duhet të kenë aftësi të shumta që të kryejnë detyrën e tyre me përgjegjësi. Përveç aftësive të përgjithshme, mësimdhënësit, përmes shkollimit, punës si mësimdhënës etj., fitojnë edhe aftësi pedagogjike, por që këto aftësi dallojnë te mësimdhënës të ndryshëm. Pavarësisht se mësimdhënësit, për të ushtruar profesionin e tyre, paraprakisht, kryejnë studimet në fushat përkatëse, si dhe gjatë përvojës së punës, kryejnë trajnime e seminare të ndryshme, marrin pjesë në konferenca e punëtori, ata nuk i disponojnë të gjitha kompetencat në nivelin e njëjtë. Ka mundësi që një mësimdhënës të jetë më i mirë në planifikimin e procesit mësimor, ndërsa mësimdhënësi tjetër të ketë aftësi më të mira në menaxhimin e procesit mësimor. Mësimdhënësit duhet të kenë aftësi të planifikojnë dhe të menaxhojnë procesin mësimor, të vlerësojnë, të bashkëpunojnë me kolegët, prindërit dhe nxënësit, me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të larta. Që të arrijnë kompetenca sa më të larta, mësimdhënësit duhet të jenë të gatshëm që, përmes arsimimit të vazhdueshëm, të ngrenë nivelin e tyre profesional e pedagogjik.

Kompetencat pedagogjike të mësimdhënësve ndihmojnë në arritjen e suksesit, zhvillojnë efikasitetin, ndihmojnë në formimin e një mësimdhënësi profesionist cilësor dhe, gjithashtu, ndikojnë në ndryshimin shoqëror sipas standardeve.

Në këtë trajtesë, janë shqyrtuar kompetencat e mësimdhënësve të shkollave të mesme të larta, me fokus të veçantë kompetencat pedagogjike të tyre.

1. SHQYRTIMI I LITERATURËS

1.1. Kompetencat e mësimdhënësve

Kompetencat e mësimdhënësit paraqesin përshkrime të vlerave profesionale, të njohurive, të shprehive dhe të shkathtësive që kërkohen për përmbushjen e një standardi të caktuar të profesionit të mësimdhënësit në kuadër të sistemit të zhvillimit në karrierë (MAShT, 2017). Kompetenca është aftësia e një personi për të ushtruar ose kryer një punë ose detyrë që bazohet në aftësi, njohuri dhe qëndrime të mbështetura nga puna, në përputhje me kërkesat e punës (Hakim, 2015).

Disa studiues e përkufizojnë "kompetencën" si një kombinim të njohurive praktike dhe teorike, aftësive njohëse, sjelljes dhe vlerave të përdorura për të përmirësuar performancën, apo si gjendja ose cilësia e të qenit i kualifikuar në mënyrë adekuate, duke pasur aftësinë për të kryer një rol specifik. Studimet mbi kompetencën tregojnë se ajo mbulon një koncept shumë të ndërlikuar dhe të gjerë dhe, me këtë rast, edhe shkencëtarë të ndryshëm kanë përkufizime të ndryshme për të. Më i përdoruri në vendet gjermanishtfolëse është përkufizimi i Franz E. Weinert: "Kompetencat janë aftësitë dhe zotësitë, të cilat mund të fitohen ose gjenden te një individ dhe që shërbejnë për t'u dhënë zgjidhje problemeve të caktuara. Aftësia dhe gatishmëria sociale për t'i përdorur në mënyrë të vullnetshme dhe me sukses këto zgjidhje, në një sërë situatash të ndryshme". (Franz, 2014). Nuk bëhet fjalë vetëm për njohuri faktesh, por, sidomos, për aftësitë që shërbejnë për zgjidhjen e problemeve dhe për qëndrimin dhe motivimin e nevojshëm për këtë. Në didaktikë vihet në dukje një ndryshim ndërmjet kompetencave kyçe profesionale dhe atyre të përgjithshme. Në kompetencat profesionale hyjnë të gjitha ato kompetenca që janë të lidhura ngushtë me një disiplinë të mësuar.

Si kompetenca të përgjithshme përcaktohen aftësitë dhe zotësitë, të cilat janë të domosdoshme për të përballuar sfidat e jetës dhe nuk janë të lidhura me një disiplinë që mësohet. Këtu bëjnë pjesë p.sh. kompetencat personale që përfshijnë mënyrat se si të sillesh në një situatë specifike (të qenit i pavarur, të reflektosh etj.), kompetencat shoqërore (aftësitë bashkëpunuese, aftësitë për të zgjidhur konfliktet etj.) por edhe kompetencat metodike: aftësitë komunikuese, aftësitë për të zgjidhur probleme (Franz, 2014). Pastaj

kompetencat njohëse, që përfshijnë përdorimin e teorive dhe të koncepteve, si dhe format e njohurive jozyrtare të fituara nga përvoja; kompetenca funksionale, gjëra të cilat një person duhet të jetë i aftë t'i kryejë kur është në një mjedis pune, aktivitet social, ose në proces të të nxënës, dhe kompetencat etike që përfshijnë zotërimin e vlerave të caktuara personale dhe profesionale (Komisioni i komuniteteve evropiane, 2005).

Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit. Kompetenca pedagogjike gjithashtu përmban aftësinë dhe gatishmërinë për të marrë pjesë në diskutime mbi pedagogjinë për të arritur zhvillimin personal dhe të kontribuojë në zhvillimin e të tjerëve.

Kompetencat kryesore

Kompetencat kryesore janë ato të cilat i nevojiten çdo individ për përmbushjen personale dhe zhvillim, qytetari aktive, përfshirje sociale dhe punësim.

Kompetencat kryesore janë:

- Kompetencat, të cilat mundësojnë një person për t'u marrë me detyrat e reja dhe komplekse;
- Kompetencat kryesore janë të dukshme në korrelacion të veprimit dhe të konteksteve sociale;
- Kompetencat kryesore janë të dobishme dhe të frytshme në shumë situata (Rahman, 2014).

Kompetencat e përgjithshme

Kompetencat e përgjithshme janë: kompetencat sociale, kompetencat vetjake, kompetencat metodologjike dhe kompetencat pedagogjike.

Kompetencat sociale

“Përfshijnë njohuritë dhe aftësitë që i mundësojnë një personi për të vepruar në mënyrë adekuate në marrëdhëniet me kolegët, anëtarët e ekipit dhe eprorët” (Kauffeld, 2006).

Kompetencat vetjake

“Aftësi dhe qëndrime për të iniciuar/motivuar dhe kontrolluar veprimet e veta në situata të ndryshme. Kompetencat vetjake janë karakteristikat personale, të cilat janë të dobishme jo vetëm në kontekstin e punës” (Kauffeld, 2006).

Kompetenca metodologjike

“Kompetencat metodologjike mundësojnë që një person të planifikojë dhe të organizojë punën e tij/saj në një mënyrë të arsyeshme dhe të strukturuar, i orientuar në arritjen e qëllimit” (Kauffeld, 2006).

Kompetenca profesionale

“Kompetencat profesionale përfshijnë njohuritë profesionale, si dhe aftësinë për të kuptuar dhe përdorur njohuritë specifike, me qëllim të orientuar dhe që drejtojnë/influençojnë ndryshimin e standardit të punës” (Kauffeld, 2006).

1.1.1. Kompetencat pedagogjike të mësimitdhënësve

Kompetenca pedagogjike është kompetenca dalluese, e cila do të dallojë profesionin e mësimitdhënies nga profesionet e tjera dhe do të përcaktojë nivelin e suksesit të procesit dhe rezultateve të të nxënësve. Mësimitdhënësit që kanë kompetencën pedagogjike janë në gjendje të menaxhojnë mirë mësimin, siç shihet nga aftësia pedagogjike për të planifikuar programe mësimore, aftësia për të zbatuar ose menaxhuar bashkëveprimin e procesit mësimor, si dhe aftësinë për të bërë një vlerësim (Rahman, 2014). Kompetenca pedagogjike ka të bëjë me atë se si një mësimitdhënës mund të sigurojë mësimitdhënie që nuk është monotone, por argëtuese, krijuese dhe domethënëse, si dhe përdor lloje të ndryshme të metodave e mjeteve mësimore. Sidoqoftë, bazuar në disa rezultate kërkimore, ka ende shumë mësimitdhënës që kanë kompetencë pedagogjike në kategorinë e ulët (Hartini, et al. 2018). Kompetenca pedagogjike në standardet kombëtare përcaktohet si aftësia për të menaxhuar mësimin e nxënësve, e cila përfshin të kuptuarit e nxënësit; hartimin dhe zbatimin,

rezultatet e të nxënit; dhe zhvillimin e nxënësve për të aktualizuar potencialin e tyre (Nouvianti&Nurlaelawati, 2019).

Në përgjithësi, kompetencat pedagogjike janë vlerësuar si një tërësi e sjelljeve/aftësive të mundshme që lejojnë manifestim efikas të një aktiviteti, ose si një standard minimal profesional, i specifikuar shpesh me ligj, të cilin profesionistët duhet ta përdorin. (Suciu&Mâță, 2011).

Nga këndvështrimi i taksonomisë, termi kompetenca pedagogjike është sinonim me detyrën specifike të punës për profesionin e mësimdhënësit, e arritur në një shkallë të caktuar të performancës (Suciu&Mâță, 2011).

Lidhur me kompetencat pedagogjike, autorë të ndryshëm japin mendime të ndryshme. Andrea Suciu përcakton dy kategori të gjera të kompetencave pedagogjike në përputhje me qasjet aktuale: kompetencë e përgjithshme pedagogjike dhe kompetencë e veçantë pedagogjike (Suciu, 2011).

Sipas **Bankauskienë**, kompetencat pedagogjike ndahen në:

a) Kompetencat e transferuara

Kompetenca shoqërore, të mësuarit për të mësuar kompetencën, kompetenca e veprimit efektiv, kompetenca komunikuese, kompetenca e menaxhimit të informacionit, kompetenca e menaxhimit të projektit, kompetenca e kërimit të veprimit.

b) Kompetenca e përgjithshme pedagogjike

Kompetenca për të zbatuar idetë arsimore dhe IT, kompetenca për të promovuar mjedise dhe programe mësimore aktive dhe inovative, kompetenca për të motivuar dhe mbështetur nxënësit, kompetenca socio-kulturore. Kompetenca e përgjithshme pedagogjike përfshin njohuritë, aftësitë, qëndrimet, vlerat dhe cilësitë e tjera personale të mësimdhënësve, të cilat janë të nevojshme për një aktivitet të suksesshëm arsimor (Bankauskienë, et al., 2005).

c) Kompetenca e veçantë pedagogjike

Kompetenca arsimore parafillore, kompetenca arsimore fillore, kompetenca arsimore e përgjithshme dhe e mesme, kompetenca e arsimit special,

kompetenca e arsimit në karrierë, kompetenca e arsimit joformal. Kompetenca e veçantë pedagogjike përbëhet nga vlerat, qëndrimet, aftësitë, njohuritë profesionale dhe cilësitë e tjera personale që ndikojnë në suksesin e veprimtarisë së mësuesve në një zonë konkrete arsimore (Bankauskienė, et al., 2005).

Duke ditur cilat janë kompetencat e detyrueshme që mësimmhënėsit duhet të kenë në të gjitha fushat e paraqitura në standarde, ata do të jenë në gjendje të reflektojnë në aftėsimin e tyre pedagogjik, si teorik ashtu edhe praktik. (Trif, 2015).

1.1.2. Profili i kompetencave të pėrgjithshme të mėsimmhėnėsve, pėrbėhet prej shtatė standardeve të grupuara në katër fusha të cilat janë:

a. Vlerat profesionale, qëndrimet dhe sjelljet

Mėsimmhėnėsit ushtrojnë qëndrime pozitive, duke promovuar vlera, dhe pėrjashtojnė qëndrimet negative, të cilat rrjedhin nga paragjykimet. Mėsimmhėnėsit punojnė ngushtë me prindėrit e nxėnėsve dhe komunitetin dhe e pranojnë se edukimi i nxėnėsve ėshtė një ndėrmarrje e pėrbashkėt.

b. Njohuritė profesionale dhe të kuptuarit

Mėsimmhėnėsit i dinė dhe i kuptojnė idetė themelore, parimet dhe strukturėn e disiplinave që ata i mėsojnė. I dinė lidhjet me fushat e tjera të pėrmbajtjes dhe janë në gjendje të integrojnë të mėsuarit pėrgjatė dhe ndėrmjet fushave të pėrmbajtjes. Ata zbatojnë qasjen me nxėnėsin në qendër, artikulojnë filozofi të ndryshme të mėsimmhėnėsies, vlerėsojnë në mėnyrė kritike teoritė e ndryshme të mėsimmhėnėsies, gjatė mėsimmhėnėsies, marrin parasysh aspekte të ndryshme sociale, kulturore, sfondin e nxėnėsve të tyre dhe ndikimet e që këto kanë në mėsimmhėnėn dhe nxėnėn efektive (MASHT, 2017).

c. Shkathtėsitė dhe praktikat profesionale

Mėsimmhėnėsit janë në gjendje të krijojnë dhe të ruajnė mjedise të sigurta, pėrfshirėse dhe sfiduese të mėsimmhėnėsies dhe nxėnėsies. Ata kanë një repertor të gjerė të strategjive dhe teknikave efektive të mėsimmhėnėsies dhe

përdorimin e tyre në zbatimin e programeve të mësimdhënies dhe të nxënit. Mësimdhënësit janë në gjendje të zgjedhin dhe të organizojnë përmbajtje në mënyrë logjike dhe të strukturuar për të përmbushur qëllimet e të mësuarit.

Ata veprojnë në mënyrë efektive në të gjitha fazat e mësimdhënies dhe të mësuarit, duke përfshirë planifikimin e mësimit, vlerësimin, zhvillimin e programeve të të mësuarit, duke siguruar reflektimin në mësimin e nxënësve dhe raportimin te prindërit.

d. Mësimi dhe angazhimi profesional

Mësimdhënësit janë në gjendje të reflektojnë mbi praktikën e tyre profesionale për t'i identifikuar nevojat e tyre për të mësuar, analizuar, vlerësuar dhe për të zgjeruar mësimin e tyre profesional. Mësimdhënësit ndërveprojnë me kolegët e tyre dhe nxënësit, punojnë në mënyrë produktive me kolegët për të përmirësuar të nxënit e nxënësve të tyre, kuptojnë dhe vlerësojnë rëndësinë e lidhjeve të ngushta në mes të shkollës, shtëpisë dhe komunitetit në zhvillimin social dhe intelektual të nxënësve të tyre (MASHT, 2017).

2. METODOLOGJIA

2.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit të kësaj teme është të konstatohen kompetencat pedagogjike të mësimdhënësve të shkollave të mesme të larta. Në kuadër të qëllimit të përgjithshëm, është bërë edhe një krahasim në mes të mësimdhënësve, duke u bazuar në karakteristikat e tyre, sa i përket nivelit të kompetencave pedagogjike.

2.2. Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit

Pyetjet e hulumtimit

- A ka dallime në mes të mësimdhënësve të drejtimeve të ndryshme të shkollave të mesme të larta, në zotërimin e kompetencave pedagogjike?

- A ka dallime në nivelin e kompetencave në bazë të numrit të trajnimeve të ndjekura të mësimeve?
- A ka dallime në bazë të moshës dhe nivelit të kompetencave të mësimeve për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike?
- Cila është ndërlidhja në mes të shkollimit të mësimeve dhe kompetencave pedagogjike?
- Cila është ndërlidhja në mes të përvojës së mësimeve dhe kompetencave pedagogjike?
- A ka ndërlidhje në mes të gjinisë së mësimeve dhe kompetencave pedagogjike?

Hipotezat e hulumtimit

Hipoteza 1:

Hipoteza alternative (HA): Mësuesit e gjimnazëve kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike sesa mësuesit e shkollave profesionale dhe të shkollave të kombinuara;

Hipoteza nul (HO): Nuk ka dallime në mes të mësimeve të arsimit të mesëm të lartë sa i përket nivelit të kompetencave pedagogjike.

Hipoteza 2:

Hipoteza alternative (HA): Mësuesit që kanë kryer trajnime më shumë, kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike;

Hipoteza nul (HO): Nuk ka dallime në nivelin e kompetencave në bazë të numrit të trajnimeve të ndjekura të mësimeve.

Hipoteza 3:

Hipoteza alternative (HA): Mësuesit e moshës më të re kanë nivel më të lartë të kompetencave për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike;

Hipoteza nul (HO): Nuk ka dallime në nivelin e kompetencave për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike, në bazë të moshës së mësimdhënësve.

Hipoteza 4:

Hipoteza alternative (HA): Mësimdhënësit që kanë shkollim më të lartë, kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike;

Hipoteza nul (HO): Nuk ka ndërlidhje në mes të shkollimit të mësimdhënësve dhe kompetencave pedagogjike.

Hipoteza 5:

Hipoteza alternative (HA): Mësimdhënësit që kanë më shumë përvojë, kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike;

Hipoteza nul (HO): Nuk ka ndërlidhje në mes të përvojës së mësimdhënësve dhe nivelit të kompetencave pedagogjike të mësimdhënësve.

Hipoteza 6:

Hipoteza alternative (HA): Ka ndërlidhje statistikisht të rëndësishme në mes të gjinisë dhe nivelit të kompetencave pedagogjike të mësimdhënësve;

Hipoteza nul (HO): Nuk ka ndërlidhje në mes të gjinisë së mësimdhënësve dhe nivelit të kompetencave pedagogjike të mësimdhënësve.

2.3. Popullacioni dhe grupi përfaqësues

Popullacionin e hulumtimit e përbëjnë të gjithë mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta në Kosovë. Sipas të dhënave statistikore të MASHT/ASK, në vitin 2019, rezultojnë të kenë qenë 5261 mësimdhënës të shkollave të mesme të larta në Kosovë (MASHT/ASK, 2019).

Grupi përfaqësues përbëhet nga 270 mësimdhënës të shkollave të mesme të larta, ku 167 ose 61.9 % e tyre janë të gjinisë femërore, 103 ose 38.1 % janë të gjinisë mashkullore, 155 ose 57.4 % punojnë në shkolla profesionale, 85 ose 31.5 % janë mësimdhënës të gjimnazëve (natyrore dhe shoqërore) dhe 30 ose 11.1 % punojnë në shkolla të kombinuara (gjimnaz dhe shkollë profesionale). Prej tyre, 33 ose 12.2 %, janë nga komuna e Ferizajt, 3 ose

1.1 % nga komuna e Fushë Kosovës, 39 ose 14.4 % nga Gjakova, 12 ose 4.5 % nga Gjilani, 9 ose 3.3 % nga Kaçaniku, 3 ose 1.1 % nga Kamenica, 9 ose 3.3 % nga Lipjani, 8 ose 3 % nga Mitrovica, 26 ose 9.6 % nga Peja, 54 ose 20 % nga Prishtina, 47 ose 17.4 % nga Prizreni, 13 ose 4.8 % nga Rahoveci, 2 ose 0.8 % nga Suhareka, 12 ose 4.5 % nga Vushtrria.

Grupi përfaqësues në bazë të moshës përbëhet, 25 ose 9.3 % të moshës deri 30-vjeçare, 81 ose 30 % të moshës 31-40-vjeçare, 61 ose 22.6 % të moshës 41-50-vjeçare, 77 ose 28.5 % të moshës 51-60-vjeçare dhe 26 ose 9.6 % e pjesëmarrësve janë të moshës mbi 60-vjeçare. Për nga shkollimi, grupi përfaqësues përbëhet nga 170 ose 63 %, e mësimdhënësve me titull master, 71 ose 26.3 % bachelor 3-vjeçar, 25 ose 9.3 % bachelor 4-vjeçar, 3 ose 1.1 % janë doktorë të shkencës, 1 ose 0.4 % PHD candidate.

Lidhur me përvojën në arsim, 36 ose 13.3 % kanë përvojë deri në 5 vjet, 48 ose 17.8 % kanë përvojë nga 6-10 vjet, 121 ose 44.8 % kanë përvojë 11-20 vjet dhe 65 ose 24.1 % e mësimdhënësve kanë përvojë në arsim mbi 20 vjet.

Lidhur me trajnimet e kryera nga mësimdhënësit, 10 ose 3.7 % prej tyre nuk kanë kryer asnjë trajnim, 42 ose 15.6 % e tyre kanë kryer nga 1-3 trajnime, 64 ose 23.7 % kanë kryer nga 4-6 trajnime, 60 ose 22.2 % kanë kryer nga 7-10 trajnime, ndërsa 94 ose 24.8 % e mësimdhënësve kanë kryer më shumë se 10 trajnime.

2.4. Instrumenti i hulumtimit

Për realizimin e këtij hulumtimi, si instrument është përdorur pyetësori për mësimdhënës.

Pyetësori është instrument i përgatitur enkas për nevojat e studimit dhe përbëhet nga 3 pjesë. Në pjesën e parë, janë paraqitur të dhënat demografike të mësimdhënësve. Në pjesën e dytë, janë paraqitur udhëzimet si të plotësohet pyetësori. Në pjesën e tretë janë parashtruar 22 pyetje që lidhen me kompetencat pedagogjike të mësimdhënësve. Pyetësori është i shkallës Likert, me 5 shkallë: 1. Aspak dakord, 2. Pjesërisht dakord, 3. Neutral, 4. Dakord, 5. Plotësisht dakord. Pas realizimit të hulumtimit, është bërë rikodimi në 3 shkallë: 1. E ulët, 2. Mesatare, 3. E lartë.

2.4.1. Besueshmëria e pyetësorit

Koeficienti i përgjithshëm i besueshmërisë së matësit, sipas modelit Cronbach's Alpha dhe modelit Parallel, është 0.895, që është vlerë e lartë dhe tregon se matësi është i besueshëm dhe mund të përdoret për hulumtim.

Tabela nr. 2.1. Rezultatet e besueshmërisë sipas modelit Alfa Chronbach's dhe Modelit Parallel

Reliability Statistics		
Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.895	.921	22

Reliability Statistics	
Common Variance	.487
True Variance	.135
Error Variance	.351
Common Inter-Item Correlation	.278
Reliability of Scale	.895
Reliability of Scale (Unbiased)	.895

2.5. Procedura e mbledhjes së të dhënave

Fillimisht pyetësi ishte përgatitur që të plotësohet në formë fizike nga mësime dhënësit, por për shkak të gjendjes së krijuar nga COVID-19 u detyruam që këtë pyetësor ta përshtatim në formën elektronike, në Google Forms. Pilotimi i pyetësorit u bë në muajin maj, me 20 mësime dhënëse, ndërsa hulumtimi u organizua gjatë muajit qershor 2020. Para se të bëhej shpërndarja, kemi siguruar numrat e telefonit dhe adresat elektronike të drejtorëve të shkollave të mesme të larta dhe pasi biseduam me ta, të gjithë pyetësorët u dërguan në adresat e tyre elektronike, pastaj ata i dërguan pyetësorët në adresat elektronike të mësime dhënëseve. Pyetësi ka qenë i ndërtuar në atë formë dhe janë dhënë udhëzime se si të plotësohet, mirëpo për çdo rast të paqartësisë është lënë numri i kontaktit dhe e-maili.

2.6. Analiza e të dhënave

Të dhënat nga hulumtimi janë analizuar përmes Paketës Statistikore për Shkencat Sociale (SPSS). Për të testuar qëndrueshmërinë e brendshme të instrumentit, janë përdorur dy modele, modeli Alpha Cronbach dhe Parallel, duke marrë vlerën mbi 0.7, si vlerë që dëshmon nëse pyetësi ka ose jo qëndrueshmëri të brendshme. Për vlerësimin e rezultateve të të gjitha testeve statistikore është vendosur niveli i domethënies statistikore 0.05.

Për të bërë krahasimin e mesatareve të mësimdhënësve, në bazë të moshës dhe shkollimit të tyre, është përdorur Testi One Way ANOVA. Testi Kruskal Wallis është përdorur për të testuar ndërlidhjen në mes të shkollës ku punojnë mësimdhënësit, numrit të trajnimeve të mësimdhënësve dhe përvojës së mësimdhënësve, lidhur me nivelin e kompetencave pedagogjike, ndërsa testi joparametrik Mann Whitney U u përdor për të matur mesataret e rezultateve të mësimdhënësve të gjinisë femërore dhe atyre të gjinisë mashkullore, lidhur me nivelin e kompetencave pedagogjike.

Për të vlerësuar ndërlidhjen në mes të variablave, u përdor Koeficienti i Korrelacionit të Pirsonit.

Koeficienti i korrelacionit:

$r=0.00-0.25$ - Lidhje shumë e dobët;

$r=0.26-0.49$ - Lidhje e dobët;

$r=0.50-0.69$ - Lidhje e mesme;

$r=0.70-0.89$ - Lidhje e lartë;

$r=0.90-1.00$ - Shumë e lartë (Kalayci, Ş., 2017)

3. REZULTATET

3.1. Rezultatet përshkruese

Lidhur me menaxhimin e mirë të klasës, 88.5 % e mësimdhënësve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 8.9 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 2.6 %, kanë nivel të ulët të kompetencave, $M=4.49$, $DS=0.765$.

Sa i përket menaxhimit të procesit mësimor, 94.1 % e mësimdhënësve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 4.4 % kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 1.5 % konsiderojnë se kanë nivel të ulët të kompetencave, $M=4.56$, $DS=0.652$.

Zbatimi i kurrikulës është me rëndësi në procesin e mësimdhënies. Rreth 80.4 % e mësimdhënësve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 13.3 % kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 6.3 % e mësimdhënësve, konsiderojnë se kanë nivel të ulët të kompetencave në zbatimin e kurrikulës, $M=4.13$, $DS=0.932$.

Që të arrihen rezultate të mira, mësimdhënësi duhet të planifikojë mirë procesin mësimor. Rreth 81.8 % e mësimdhënësve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 11.9 % e tyre konsiderojnë se kanë kompetenca të nivelit të mesëm, ndërsa 6.3 % e mësimdhënësve konsiderojnë se kanë nivel të ulët të kompetencave në planifikimin e procesit mësimor si duhet dhe bazuar në kurrikulë, $M=4.24$, $DS=0.956$.

Rreth 80.7 % e mësimdhënësve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 11.9 % e tyre konsiderojnë se kanë kompetenca të nivelit të mesëm dhe 7.4 % e tyre konsiderojnë se kanë kompetenca të nivelit të ulët, sa u përket njohurive të mira në përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike, $M=4.13$, $DS=0.919$.

Rreth 64.8 % e mësimdhënësve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 12.2 % e tyre konsiderojnë se kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 23% kanë nivel të ulët kompetencave në menaxhimin e mbingarkesës në punë, $M=3.81$, $DS=1.366$.

Rreth 88.8 % e mësimdhënësve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 8.5 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 2.6 % kanë nivel të ulët të kompetencave në përdorimin e formave të llojllojshme, $M=4.3$, $DS=0.763$.

Rreth 87.7 % e mësimdhënësve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 10 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 2.3 % kanë nivel të ulët të kompetencave në përdorimin e metodave të llojllojshme, $M=4.32$, $DS=0.759$.

Rreth 92.3 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 7 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 0.7 % kanë nivel të ulët të kompetencave në përdorimin e teknikave efektive të pyetjeve, $M=4.47$, $DS=0.660$.

Rreth 91.8 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 7 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 1.1 % kanë nivel të ulët të kompetencave në përdorimin e strategjive dhe teknikave të ndryshme gjatë mësimit, $M=4.41$, $DS=0.672$.

Rreth 92.4 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 5.9 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 1.5 % kanë nivel të ulët të kompetencave në ndërveprimin me nxënësin në forma të ndryshme, $M=4.47$, $DS=0.693$.

Rreth 91.1 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 7.8 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 1.1 %, kanë nivel të ulët të kompetencave në mbajtjen e taktit gjatë komunikimit me nxënësin, $M=4.5$, $DS=0.687$.

Rreth 92.8 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 5.9 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 1.1 % kanë nivel të ulët të kompetencave për komunikim të qartë me nxënësin, $M=4.61$, $DS=0.651$.

Rreth 88.1 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 9.3 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 2.6 %, kanë nivel të ulët të kompetencave për zhvillimin e talentit të nxënësit, $M=4.44$, $DS=0.768$.

Rreth 90.7 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 7.8 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 1.5 % kanë nivel të ulët të kompetencave për të kuptuarit e interesave të nxënësit, $M=4.46$, $DS=0.703$.

Rreth 92.2 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 7 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 0.7 %, kanë nivel të ulët të kompetencave për t'i motivuar nxënësin, $M=4.57$, $DS=0.658$.

Rreth 94.1 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 5.5 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 0.4 % kanë nivel të ulët të kompetencave në angazhimin e të gjithë nxënësve në kryerjen e aktiviteteve në klasë, $M=4.59$, $DS=0.614$.

Rreth 94.8 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 4.5 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 0.7 % kanë nivel të ulët të kompetencave në menaxhimin e disiplinës në klasë, $M=4.61$, $DS=0.610$.

Rreth 92.9 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 6 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 1.1 % kanë nivel të ulët të kompetencave në përdorimin e aftësive efektive të negociatave dhe zgjidhjes së problemeve/konflikteve, $M=4.48$, $DS=0.661$.

Rreth 94.4 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 4.9 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 0.7 % kanë nivel të ulët të kompetencave në ofrimin e ndihmës që nxënësit të zhvillojnë të kuptuarit/njohuritë, aftësitë apo shkathtësitë, $M=4.61$, $DS=0.616$.

Rreth 91.3 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 8.1 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave në vlerësimin e vazhdueshëm të nxënësve, $M=4.64$, $DS=0.628$.

Rreth 84.4 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë të kompetencave, 13.7 % e tyre kanë nivel të mesëm të kompetencave dhe 1.9 %, kanë nivel të ulët të kompetencave në shfrytëzimin e metodave të shumta të komunikimit me prindër, $M=4.36$, $DS=0.799$.

Rezultatet e përgjithshme treguan se 88.7 % e mësimeve konsiderojnë se kanë nivel të lartë kompetencave pedagogjike, 8.3 % e tyre konsiderojnë se kompetencat e tyre pedagogjike janë në nivelin mesatar, ndërsa 3 % e mësimeve konsiderojnë se kompetencat pedagogjike, i kanë në nivel të ulët, mesatarja e përgjithshme, $M=4.4$.

Tabela nr. 3.1. Rezultatet përshkruese

Pyetjet	E lartë	Mesme	E ulët	M	DS
Unë e menaxhoj mirë klasën	88.5%	8.9%	2.6 %	4.49	.765
Unë e menaxhoj procesin mësimor mirë	94.1%	4.4%	1.5%	4.56	.652
Unë arrij ta zbatoj mirë kurrikulën	80.4%	13.3%	6.3%	4.13	.932
E planifikoj procesin mësimor si duhet dhe bazuar në kurrikulë	81.8%	11.9%	6.3%	4.24	.956
Kam njohuri të mira për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike	80.7%	11.9%	7.4%	4.13	.919
Nuk kam vështirësi të menaxhoj mbingarkesat në punë	64.8%	12.2%	23%	3.81	1.366
Përdor llojllojshmëri të formave mësimore	88.8%	8.5%	2.6%	4.30	.763
Përdor llojllojshmëri të metodave mësimore	87.7%	10%	2.3%	4.32	.759
Përdor teknika efektive të pyetjeve	92.3%	7%	0.7%	4.47	.660
Përdor strategji e teknika të ndryshme gjatë mësimdhënies	91.8%	7%	1.1%	4.41	.672
Gjatë procesit mësimor, ndërveproj me nxënësit në forma të ndryshme	92.6%	5.9%	1.5%	4.47	.693
Kam takt në komunikim me nxënësit	91.1%	7.8%	1.1%	4.55	.687
Kam komunikim të qartë me nxënësit	92.8%	5.9%	1.1%	4.61	.651
Punoj për zhvillimin e talentit të nxënësve	88.1%	9.3%	2.6%	4.44	.768
Kam njohuri për interesimin e nxënësve	90.7%	7.8%	1.5%	4.46	.703
Di si t'i motivoj nxënësit	92.2%	7%	0.7%	4.57	.658
I angazhoj të gjithë nxënësit në kryerjen e aktiviteteve në klasë	94.1%	5.5%	0.4%	4.59	.614
Jam në gjendje ta menaxhoj disiplinën në klasën time	94.8%	4.5%	0.7%	4.61	.610
Përdor aftësi efektive të negociatave dhe zgjidhjes së problemeve/konflikteve	92.9%	6.0%	1.1%	4.48	.661
Ju ndihmoj nxënësve të zhvillojnë të kuptuarit/njohuritë, aftësitë apo shkathtësitë e tyre	94.4%	4.9%	0.7%	4.61	.616
Vlerësimin e nxënësve e bëj gjatë gjithë vitit mësimor	91.3%	8.1%	0%	4.64	.628
Shfrytëzoj metoda të shumta të komunikimit me prindërit (takime, shënime, telefonata, përmes platformave të ndryshme elektronike, si viber, zoom, email, etj.)	84.4%	13.7%	1.9%	4.36	.799
Rezultatet e përgjithshme	88.7%	8.3%	3%	4.4	////

3.2. Rezultatet korrelacionale

Korrelacion i lartë ekziston në mes të pyetjes së tretë dhe pyetjes së katër, $r=0.775^{**}$, pyetjes së shtatë dhe pyetjes së tetë, 0.789^{**} .

Korrelacion të mesëm kemi në mes të pyetjes së parë dhe pyetjes së dytë, $r=0.672^{**}$, pyetjes së parë dhe pyetjes së tetëmbëdhjetë, $r=0.513^{**}$, pyetjes së dytë me pyetjen e katërmëdhjetë, $r=0.510^{**}$, me pyetjen e pesëmbëdhjetë, $r=0.545^{**}$, me pyetjen e gjashtëmbëdhjetë, $r=0.507^{**}$, me pyetjen e tetëmbëdhjetë, $r=0.546^{**}$, me pyetjen e nëntëmbëdhjetë, $r=0.516^{**}$, në mes të pyetjes së shtatë dhe pyetjes së dhjetë, 0.549^{**} , pyetjes së tetë dhe pyetjes së dhjetë, $r=0.606^{**}$, pyetjes së tetë dhe pyetjes së njëmbëdhjetë, $r=0.501^{**}$, pyetjes së nëntë dhe pyetjes së dhjetë, $r=0.580^{**}$, pyetjes së nëntë dhe pyetjes së gjashtëmbëdhjetë, $r=0.517^{**}$, pyetjes së dhjetë dhe pyetjes së njëmbëdhjetë, $r=0.561^{**}$, pyetjes së dhjetë dhe pyetjes së katërmëdhjetë, $r=0.507$, pyetjes së dhjetë dhe pyetjes së gjashtëmbëdhjetë, $r=0.554^{**}$, pyetjes së dymbëdhjetë dhe pyetjes së trembëdhjetë, $r=0.554^{**}$, pyetjes së dymbëdhjetë dhe pyetjes së gjashtëmbëdhjetë, $r=0.530^{**}$, pyetjes së trembëdhjetë dhe pyetjes së pesëmbëdhjetë, $r=0.579^{**}$, pyetjes së trembëdhjetë dhe pyetjes së gjashtëmbëdhjetë, $r=0.588^{**}$, pyetjes së trembëdhjetë dhe pyetjes së shtatëmbëdhjetë, $r=0.504^{**}$, pyetjes së trembëdhjetë dhe pyetjes së njëzetë, $r=0.635^{**}$, pyetjes së pesëmbëdhjetë dhe pyetjes së gjashtëmbëdhjetë, $r=0.589^{**}$, pyetjes së pesëmbëdhjetë dhe pyetjes së shtatëmbëdhjetë, $r=0.550^{**}$, pyetjes së pesëmbëdhjetë dhe pyetjes së tetëmbëdhjetë, $r=0.522^{**}$, pyetjes së gjashtëmbëdhjetë dhe pyetjes së shtatëmbëdhjetë, $r=0.606^{**}$, pyetjes së gjashtëmbëdhjetë dhe pyetjes së tetëmbëdhjetë, $r=0.533^{**}$, pyetjes së gjashtëmbëdhjetë dhe pyetjes së njëzetë, $r=0.540$, pyetjes së shtatëmbëdhjetë dhe pyetjes së tetëmbëdhjetë, $r=0.542^{**}$, pyetjes së tetëmbëdhjetë dhe pyetjes së nëntëmbëdhjetë, 0.571^{**} .

Korrelacionet e paraqitura më lart janë të rëndësishme për nivelin 0.01. Të gjitha korrelacionet tjera, në mes të variablave, janë të ulëta, andaj nuk janë paraqitur fare në këtë punim.

3.3. Rezultatet lidhur me hipotezat

Në këtë pjesë janë paraqitur rezultatet që lidhen me hipotezat. Për të testuar hipotezat, janë përdorur disa metoda statistikore.

Hipoteza 1:

Hipoteza alternative (HA): Mësimdhënësit e gjimnazeve kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike sesa mësimdhënësit e shkollave profesionale dhe të shkollave të kombinuara.

Hipoteza nul (HO): Nuk ka dallime ndërmjet mësimdhënësve të arsimit të mesëm të lartë sa i përket nivelit të kompetencave pedagogjike.

Testimi i hipotezës është kryer përmes testit joparametrik Kruskal Wallis Test, i cili është alternativ i testit parametrik ANOVA njëdrejtimëshe. Rezultatet treguan se mesataren më të lartë për kompetencat pedagogjike e kanë mësimdhënësit e gjimnazit, $M=141.05$, pastaj mësimdhënësit e shkollës profesionale, $M=139.53$, ndërsa mesataren më të ulët për kompetencat pedagogjike e kanë mësimdhënësit e shkollave të kombinuara, $M=98.93$, vlera e $X^2=7.438$, $p=0.024<0.05$. Në bazë të këtyre rezultateve, vërehet se mësimdhënësit e gjimnazeve kanë nivelin më të lartë të kompetenca pedagogjike sesa mësimdhënësit e shkollave profesionale dhe shkollave të kombinuara dhe dallimi është i rëndësishëm statistikisht. Nga rezultatet empirike, u gjet se është mbështetur hipoteza alternative.

Tabela nr. 3.2. Testimi i hipotezës përmes Kruskal Wallis Test

Ranks			
	Shkolla	N	Mean Rank
Kompetencat pedagogjike	Gjimnaz	85	141.05
	E kombinuar	30	98.93
	Shkollë profesionale	155	139.53
	Total	270	

Test Statistics ^{a,b}	
Kompetencat pedagogjike	
Chi-Square	7.438
df	2
Asymp. Sig.	.024

a. Kruskal Wallis Test

b. Grouping Variable: Skolla

Hipoteza 2:

Hipoteza alternative (HA): Mësimdhënësit që kanë kryer trajnime më shumë, kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike.

Hipoteza nul (HO): Nuk ka dallime në nivelin e kompetencave në bazë të numrit të trajnimeve të ndjekura të mësimdhënësve.

Testimi i hipotezës është kryer përmes testit joparametrik Kruskal Wallis Test.

Nga rezultatet empirike u gjet se mesataren më të lartë për kompetencat pedagogjike e kanë mësimdhënësit që kanë kryer mbi 10 trajnime, $M=152.56$, mësimdhënësit që kanë kryer 4-6 trajnime, $M=134.82$, pastaj mësimdhënësit që kanë kryer 7-10 trajnime, $M=124.69$, mësimdhënësit që kanë kryer 1-3 trajnime, $M=123.12$, ndërsa mesataren më ulët e kanë mësimdhënësit që nuk e kanë kryer asnjë trajnim, $M=99.09$, $X^2=9.095$, $p=0.059>0.05$.

Rezultatet treguan se mësimdhënësit që kanë kryer më shumë se 10 trajnime kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike sesa mësimdhënësit e tjerë, mirëpo dallimi është i parëndësishëm statistikisht. Nga këto rezultate, mund të themi se nuk është mbështetur hipoteza alternative.

Tabela nr. 3.3. Testimi i hipotezës përmes Kruskal Wallis Test

Ranks			
	Trajnimet e kryera	N	Mean Rank
Kompetencat pedagogjike	Mbi 10	94	152.56
	7-10	58	124.69
	4-6	64	134.82
	1-3	43	123.12
	Asnjë trajnim	11	99.09
	Total	270	

Test Statistics ^{a,b}	
Kompetencat pedagogjike	
Chi-Square	9.095
df	4
Asymp. Sig.	.059

a. Kruskal Wallis Test

b. Grouping Variable: Trajnimet e kryera

Hipoteza 3:

Hipoteza alternative (HA): Mësimdhënësit e moshës më të re kanë nivel më të lartë të kompetencave për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike.

Hipoteza nul (HO): Nuk ka dallime në nivelin e kompetencave për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike, në bazë të moshës së mësimdhënësve.


Testimi i hipotezës është kryer përmes testit parametrik ANOVA. Nga rezultatet empirike, u gjet se mësimdhënësit e moshës deri 30 vjet dhe ata të moshës 31-40 vjet kanë mesataren më të lartë, $M=4.4$, pastaj mësimdhënësit e moshës 51-60, $M=4.16$, mësimdhënësit e moshës 41-50, $M=4.13$, ndërsa mesataren më të ulët e kanë mësimdhënësit e moshës mbi 60 vjet, $M=3.81$, vlera e $F=2.750$, $p=0.29<0.05$. Në bazë të këtyre rezultateve, u gjet se dallimet në mes të rezultateve të mësimdhënësve, lidhur me kompetencat për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike, janë të rëndësishme statistikisht, andaj mund të konstatojmë se është mbështetur hipoteza alternative.

Tabela nr. 3.4. Krahësimi i rezultateve lidhur me kompetencat për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike

Descriptives						
Kam njohuri të mira për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike						
	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	95% Confidence Interval for Mean	
					Lower Bound	Upper Bound
Deri 30	25	4.40	1.000	.200	3.99	4.81
31-40	81	4.40	.769	.085	4.22	4.57
41-50	62	4.13	1.000	.127	3.88	4.38
51-60	75	4.16	.789	.091	3.98	4.34
Mbi 60	27	3.81	1.001	.193	3.42	4.21
Total	270	4.21	.890	.054	4.10	4.32

ANOVA

Kam njohuri të mira për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike					
	Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	8.487	4	2.122	2.750	.029
Within Groups	204.480	265	.772		
Total	212.967	269			



Grafiku nr. 3.1. Mesatarja e rezultateve të mësimdhënësve lidhur me kompetencat për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike

Hipoteza 4:

Hipoteza alternative (HA): Mësimdhënësit që kanë shkollim më të lartë, kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike.

Hipoteza nul (HO): Nuk ka ndërlidhje ndërmjet shkollimit të mësimdhënësve dhe kompetencave pedagogjike.

Testimi i hipotezës u bë përmes testit parametrik, ANOVA. Në bazë të rezultateve, u gjet se nivelin më të lartë të kompetencave pedagogjike e kanë

mësimdhënësit me bachelor 4-vjeçar, $M=100.84$, pastaj ata me doktoratë, apo që janë në studime të doktoratës, $M=100.75$, mësimdhënësit me master $M=99.25$, dhe nivelin më të ulët të kompetencave e kanë mësimdhënësit që kanë kryer studimet bachelor 3-vjeçar, $M=98.01$, $F=0.823$, $p=0.482>0.05$. Rezultatet treguan se nuk ka ndërlidhje statistikisht të rëndësishme në mes të shkollimit të mësimdhënësve dhe kompetencave pedagogjike të tyre. Nga këto të gjetura, mund të konstatohet se nuk është mbështetur hipoteza alternative.

Tabela nr. 3.5. Testimi i hipotezës në bazë të shkollimit të mësimdhënësve

Descriptives						
Kompetencat pedagogjike						
	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	95% Confidence Interval for Mean	
					Lower Bound	Upper Bound
Bachelor 3-vjeçar	71	98.01	8.841	1.049	95.92	100.11
Bachelor 4-vjeçar	25	100.84	7.122	1.424	97.90	103.78
Master	170	99.25	8.400	.644	97.98	100.52
Doktor i shkencës ose PHD candidate	4	100.75	6.850	3.425	89.85	111.65
Total	270	99.09	8.388	.510	98.09	100.10

ANOVA					
Kompetencat pedagogjike					
	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	173.966	3	57.989	.823	.482
Within Groups	18752.719	266	70.499		
Total	18926.685	269			

Hipoteza 5:

Hipoteza alternative (HA): Mësimdhënësit që kanë më shumë përvojë, kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike.

Hipoteza nul (HO): Nuk ka ndërlidhje në mes të përvojës së mësimdhënësve dhe nivelit të kompetencave pedagogjike të mësimdhënësve.

Testimi i hipotezës është kryer përmes testit joparametrik, Kruskal Wallis Test.

Nga rezultatet empirike u gjet se mesataren më të lartë, lidhur me nivelin e kompetencave pedagogjike, e kanë mësimdhënësit me mbi 20 vjet përvojë, $M=140.42$, pastaj mësimdhënësit me përvojë 6-10 vjet, $M=138.71$, pastaj ata me përvojë 11-20 vjet, $M=134.93$, ndërsa, në bazë të rezultateve, nivelin më të ulët të kompetencave e kanë mësimdhënësit që kanë përvojë më së paku deri 5 vjet, $M=124.26$, $X^2=1.094$, $p=0.779>0.05$. Dallimet që ekzistojnë në zotërimin e kompetencave nuk kanë rëndësi statistikore, andaj mund të konstatohet se nuk është mbështetur hipoteza alternative.

Tabela nr. 3.6. Testimi i hipotezës së pestë, përmes Kruskal Wallis Test

	Ranks		
	Përvoja	N	Mean Rank
Kompetencat pedagogjike	Deri 5 vjet	36	124.26
	6-10	48	138.71
	11-20	121	134.93
	Mbi 20 vjet	65	140.42
	Total	270	

Test Statistics ^{a,b}	
Kompetencat pedagogjike	
Chi-Square	1.094
Df	3
Asymp. Sig.	.779

a. Kruskal Wallis Test

b. Grouping Variable: Përvoja

Hipoteza 6:

Hipoteza alternative (HA): Ka ndërlidhje statistikisht të rëndësishme në mes të gjinisë dhe nivelit të kompetencave pedagogjike të mësimdhënësve.

Hipoteza nul (HO): Nuk ka ndërlidhje ndërmjet gjinisë së mësimdhënësve dhe nivelit të kompetencave pedagogjike të mësimdhënësve.

Testimi i hipotezës u bë përmes testit joparametrik, Mann-Whitney U, i cili është alternativ i testit parametrik T-test.

Rezultatet treguan se mesatarja e rezultateve për mësimdhënësit e gjinisë femërore, lidhur me nivelin e kompetencave pedagogjike, është $M=144.85$, ndërsa mesatarja e rezultateve për mësimdhënësit e gjinisë mashkullore, $M=120.34$, $U=7039$, $Z=-2.508$, $p=0.012<0.05$. Nga këto rezultate u gjet se ka dallime statistikisht të rëndësishme ndërmjet mësimdhënësve të gjinisë femërore dhe mësimdhënësve të gjinisë mashkullore. Rezultoi se mësimdhënëset e gjinisë femërore kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike sesa mësimdhënësit e gjinisë mashkullore. Nga këto rezultate, mund të konstatojmë se është mbështetur hipoteza alternative.

Tabela nr. 3.7. Testimi i hipotezës së gjashtë, përmes testit Mann-Whitney U

Ranks				
	Gjinia	N	Mean Rank	Sum of Ranks
Kompetencat pedagogjike	Femër	167	144.85	24190.00
	Mashkull	103	120.34	12395.00
	Total	270		

Test Statistics ^a	
	Kompetencat pedagogjike
Mann-Whitney U	7039.000
Wilcoxon W	12395.000
Z	-2.508
Asymp. Sig. (2-tailed)	.012

a. Grouping Variable: Gjinia

4. DISKUTIMI I REZULTATEVE

4.1. Diskutimi lidhur me rezultatet përshkruese

Rezultatet e përgjithshme treguan se 88.7 % e mësimeve pretendojnë se kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike, 8.3 % e tyre konsiderojnë se kompetencat e tyre pedagogjike janë në nivelin mesatar, ndërsa 3 % e mësimeve konsiderojnë se kompetencat pedagogjike i kanë në nivel të ulët, mesatarja e përgjithshme, $M=4.4$. Duke analizuar këto rezultate, vërehet se mësuesit kanë vetëbesim të madh për kompetencat e tyre pedagogjike.

4.2. Diskutimi lidhur me korrelacionet

Nga rezultatet e korrelacionit, u gjet se korrelacion i lartë ekziston vetëm në mes të pyetjes së tretë dhe pyetjes së katër, $r=0.775^{**}$, pyetjes së shtatë dhe pyetjes së tetë, 0.789^{**} , të gjitha korrelacionet e tjera janë mesatare dhe të ulëta. Nuk u gjet asnjë ndërlidhje e rëndësishme në mes të variablave të pavarura dhe variablave të varura.

4.3. Diskutimi lidhur me hipotezat e hulumtimit

- Diskutimi i rezultateve lidhur me hipotezën: Mësuesit e gjimnazëve kanë kompetenca më të larta pedagogjike sesa mësuesit e shkollave profesionale dhe të shkollave të kombinuara.

Rezultatet empirike treguan se ka dallime në nivelin e kompetencave ndërmjet mësimeve të gjimnazëve, shkollave profesionale dhe shkollave të kombinuara. Nga rezultatet empirike u kuptua se mësuesit e gjimnazëve kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike, pasi që kanë mesataren $M=141.05$, pas këtyre radhitën mësuesit e shkollave profesionale, $M=139.53$, ndërsa mesataren më të ulët për kompetencat pedagogjike e kanë mësuesit e shkollave të kombinuara, $M=98.93$. Dallimi i nivelit të kompetencave në mes të mësimeve është i rëndësishëm statistikisht. Nga rezultatet empirike, u gjet se është mbështetur hipoteza alternative.

- Diskutim i rezultateve lidhur me hipotezën: Mësimdhënësit e moshës më të re kanë kompetenca më të larta për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike.

Me qëllim të konstatimit lidhur me kompetencat e mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike, u krahasuan rezultatet e mësimdhënësve të moshave të ndryshme. Nga rezultatet empirike u gjet se mësimdhënësit e moshës më të re (grupmosha deri 30 vjet dhe 31-40 vjet) kishin nivel më të lartë të kompetencave për përdorimin e TIK-ut dhe platformave elektronike sesa mësimdhënësit e moshave të tjera. Nga ky rezultat mund të konstatojmë se është mbështetur hipoteza alternative. Në një studim u gjet se vetefikasiteti i mësimdhënësve në njohuri për përmbajtjen pedagogjike ka ndryshuar në bazë të moshës (Yasar&Pinar, 2014).

- Diskutim i rezultateve lidhur me hipotezën: Ka ndërlidhje statistikisht të rëndësishme ndërmjet gjinisë dhe kompetencave pedagogjike të mësimdhënësve.

Rezultatet empirike treguan se mesatarja e rezultateve për mësimdhënësit e gjinisë femërore, lidhur me kompetencat pedagogjike, është $M=144.85$ dhe është më e lartë se e mësimdhënësve të gjinisë mashkullore, e cila është $M=120.34$, vlera e $U=7039$, $Z=-2.508$, $p=0.012<0.05$. Nga këto rezultate u gjet se mësimdhënësit e gjinisë femërore kanë nivel më të lartë të kompetencave pedagogjike sesa mësimdhënësit e gjinisë mashkullore. Në një studim të kryer në vitin 2014, u gjet se ka dallime gjinore sa u përket njohurive pedagogjike. Në këtë studim u gjet se perceptimi i vetefikasitetit të mësimdhënësve të gjinisë femërore ishte më i lartë se i atyre të gjinisë mashkullore (Yasar&Pinar, 2014). Gjithashtu, edhe në një studim tjetër u gjet se mësimdhënëset perceptojnë vetëbesim më të lartë në njohuritë pedagogjike sesa mësimdhënësit. (Linnet al., 2013).

Literatura

1. Bankauskienė, N., Augustinienė, A., Čiučiulkienė, N. (2005). The expression of teacher competencies in action research field: the case-based study of KTU teacher education program Pedagogy. Paper presented at the

- European Conference on Educational Research, University College Dublin, 7-10.
2. Maliqi, B. (2012). Etika pedagogjike si faktor në edukim, Disertacion doktrate, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Tiranë.
 3. Cohen. L., et al. (2000). Research Methods in Education (Metodat kërkimore në shkenca sociale), fifth edition, London.
 4. Hakim, Adnan. (2015). Contribution of Competence Teacher (Pedagogical, Personality, Professional Competence and Social) On the Performance of Learning, IJES. Vol. 4, Issue 2, p-1-12, ISSN (e): 2319 – 1813 ISSN (p): 2319 – 1805
 5. Hartini, S. et al. (2018). Teacher pedagogic competency development model: A literature review, semantic Scholar, ISSN: 2352-5398.
 6. Zylfiu, H.; Potera, I.; Alija, R. (2015), Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale në Kosovë 2010- 2015, Instituti Pedagogjik i Kosovës.
 7. Kalayci, Ş. (2017). Teknikat statistikore me shumë ndryshore me aplikim SPSS.
 8. Kauffeld, S. (2006): Kompetenzen messen, bewerten, entwickeln. Ein prozessanalytischer Ansatz für Gruppen. Stuttgart, fq. 23-26.
 9. Komisioni i komuniteteve evropiane (2005), Drejt një kuadri evropian të kualifikimit për të mësuarin gjatë gjithë jetës, Bruksel.
 10. König, Johannes, Sigrid Blömeke & Gabriele Kaiser. (2015). Early Career Mathematics Teachers' General Pedagogical Knowledge and Skills: Do Teacher Education, Teaching Experience, and Working Conditions Make a Difference? International Journal of Science and Mathematics Education volume 13, pages331–350.
 11. Lin, Tzu-Chiang, Chin-Chung Tsai, Ching Sing Chai & Min-Hsien Lee. (2013). Identifying Science Teachers' Perceptions of Technological Pedagogical and Content Knowledge (TPACK), Journal of Science Education and Technology volume 22, pages325–336
 12. Mardia Hi. R. (2014), Professional Competence, Pedagogical Competence and the Performance of Junior High School of Science Teachers.
 13. MAShT (2013), Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional.
 14. MAShT (2014), Udhëzim Administrativ, Organizimi dhe planifikimi i procesit arsimor në arsimin dhe aftësimin profesional.
 15. MAShT (2016), Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017- 2021.

16. MASHT (2017), Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë.
17. Nouvianti, N. & Iyen Nurlaelawati. (2019). Pedagogical competence development of university teachers with non-education background: The case of a large university of education in Indonezia, IJE, vol. 11, no. 2, pp. 169-177.
18. Rahman, M. Hi. (2014). Professional Competence, Pedagogical Competence and the Performance of Junior High School of Science Teachers, Journal of Education and Practice, ISSN 2222-1735 (Paper) ISSN 2222-288X (Online), Vol.5, No.9, pp 75-80.
19. Statistikat e Arsimit në Kosovë. (2019). ASK/MASHT, SMIA 2018-2019.
20. Suciu, I. A. (2011). Pedagogical Competences-The key to efficient education, semantic Scholar.
21. Suciu, I. A.&L. Măță (2011). Pedagogical Competences-The key to efficient education, "IOJES", 3 (2), 411-423.
22. Trif, Letitia. (2015). Teachers Professional Competencies. Professional development, plus education, vol 12 no 1.
23. Weinert, Franz E. (2014). Leistungsmessungen in Schulen. Weinheim und Basel: Beltz.
24. Yasar, I. K.&Erten Pinar. (2014). Teachers' Technological Pedagogical Content Knowledge Self-Efficacies, Journal of Education and Training Studies, v2 n2 p126-144.